



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 100, Datë 20.03.2023

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS TË SHOQËRISË
“GEN-I TIRANA” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 gërma “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1 gërma “e”, nenit 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1 gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.03.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1033/1 prot, datë 16.03.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës Nr. 74 Seria T08P, të shoqërisë “GEN-I Tirana” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 202, datë 13.09.2018”,

Konstatohet se:

- Shoqëria “GEN-I Tirana” sh.p.k., me vendimin e bordit të ERE-s nr. 202, datë 13.09.2018 është licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar. Kjo licencë përfundon më datë 13.09.2023.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1039 prot., datë 09.03.2023 shoqëria, ka paraqitur kërkesën për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Shoqëria e ka paraqitur aplikimin e saj brenda afatit të parashikuar në nenin 16, pika 1 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të Aneksit A të Rregullores dhe po ashtu ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit.
- Në zbatim të përcaktimeve të Rregullores, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: formatin e plotësuar të aplikimit, sipas Shtojcës 1; çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të

dokumentacionit të të dhënave teknike apo dokumentacionit tjetër të depozituar në aplikimin për pajisje me licencë; informacion mbi ushtrimin e veprimtarisë e licencuar (kontrata për shitblerjen e energjisë, nëse ka pasur). Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë kryesisht dokumentacionin si vijon:

- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “GEN-I Tirana” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin si vijon: **Neni 16, gërmat “a”, “b” dhe “c”.**

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës të shoqërisë “GEN-I Tirana” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 14.09.2023.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETARI

Petrit AHMETI